

Projekt kërkimi : « Kushtet e punës dhe shëndetit të prindërve gjatë vitit të parë pas lindjes së fëmijës »

Fusha 1 : Takimet me prindërit

Udhëzues informativ për pjesëmarrësit (- et)

Projekti i kërkimit

Si ndikon puna tek shëndeti dhe mirëqënia e prindërve gjatë vitit të parë të jetës të fëmijës ? Kushtet e punës janë të përshtatshme me nevojat e prindërve ?

Për t'a ditur, ne bëjmë një kërkim pranë prindërve që banojnë në kantonin e Vaud, që kanë pasur një aktivitet profesional (me rrogë ose të pavarur), përpara lindjes së fëmijës së tyre – ose fëmijëve në rast se janë binjakë – dhe që pas lindjes, kanë rifilluar punën.

Ne kemi takuar rreth 50 nëna dhe baballarë, për të kuptuar përvojën e tyre profesionale. Qëllimi është të identifikohet llojshmëria e përvojave të jetuara nga prindërit në këtë periudhë, dhe për bërë këtë gjë, takojmë një panel të gjerë dhe të ndryshëm me pjesëmarrës (-e).

Pjesëmarrja juaj

Ju propozojmë të merrni pjesë në një takim prej rreth 1 orë e 15 minuta, i cili do të bëhet me një anëtar të ekipit tonë të kërkimit. Ky takim do të bëhet në një vend, i cili mund të zgjidhet nga ju, në zyrat e HESAV, ose në Unisanté, për shembull. Takimi mund të bëhet në gjuhën që dëshironi. Me kërkesën tuaj, mund të kërkojmë një përkthyes (-e), që ne do të kontaktojmë dhe do të paguajmë.

Gjatë këtij takimi, do ju kërkojmë të flisni për vitin pas lindjes së fëmijës tuaj, duke e trajtuar çështjen si prind, për kushtet e punës, organizimin tuaj familjar, si edhe për shëndetin dhe mirëqënien tuaj.

Përfitimet e pjesëmarrjes tuaj në këtë studim

Duke pranuar të merrni pjesë në këtë studim, **ju kontribuoni në zhvillimin e njohurive rreth shëndetit të prindërve gjatë kësaj periudhe të rëndësishme të jetës.**

Ne shpresojmë që të ndihmojmë të përmirësohen kushtet e punës dhe mbështetja e ofruar ndaj prindërve që punojnë, për të ndihmuar shëndetin dhe mirëqënien e tyre, dhe në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë, të fëmijëve të tyre.

Për t'ju falenderuar për pjesëmarrjen tuaj, ju do merrni **një bono prej 80 CHF.**

Përdorimi i të dhënave të mbledhura

Të dhënat e marra nga takimet, do të analizohen me ato të pjesëmarrësve (-eve) të tjerë dhe do të përdoren për qëllime kërkimi dhe mësimi vetëm nga anëtarët e ekipit.

Fshehtësia

Për arsye metodologjike, ne duhet të **regjistrojmë këto takime**, për të mos ndryshuar fjalët tuaja. Për këtë, kërkojmë miratimin tuaj në fillim të takimit. Takimet do jenë të transkriptuara. Emri juaj do shënohet me një kod, si edhe vendi juaj i punës, apo informacionet e tjera që mund t'ju identifikojnë. Ne do të fshijmë regjistrimet pasi t'i kemi transkriptuar ato

Të dhënat që marrim nga takimet, do përdoren vetëm nga anëtarët e ekipit të kërkimit, në përputhje me Ligjin federal për mbrojtjen e të dhënave (LPD). Ne do i trajtojmë në mënyrë plotësisht të fshehtë. Asnjë informacion i cili mund t'ju identifikojë, nuk do jetë në raporte, publikime, apo prezantime.

Të dhënat e koduara do të ruhen në një server të sigurtë, për një periudhë prej 10 vitesh, më pas do fshihen në mënyrë të përhershme. Vetëm anëtarët e ekipit të kërkimit do të kene akses.

Tërheqja nga projekti

Ju mund të tërhiqeni në çdo moment të projektit të kërkimit, pa pasur nevojë të justifikoheni. Ju mund të shkruani një email, ose të telefonin tek të dhënat e kontaktit që janë shkruar më poshtë. Të dhënat tuaja do të fshihen.

Ekipi i kërkimit

Projekti i kërkimit realizohet nga Haute École de Santé - Vaud si edhe nga Departamenti i Shëndetit në punë, dhe Mjedisit i Unisanté. Ai financohet nga Fonds National Suisse.

Përgjegjës të studimit : Isabelle Probst, psikologe PhD, profesore e asociuar në HESAV - Haute École de Santé - Vaud (HES-SO) et **Peggy Krief**, mjeke pune MD, zv-mjeke dhe lektore mësimdhënie dhe kërkimi klinik në Unisanté (Qendra Universitare e mjekësisë së përgjithshme dhe shëndetit publik).

E ngarkuar me studimin : Aline Sadowski, psikologe, doktorante dhe **Amandine Mudry**, psikologe PhD, post-doktorante.

Si të informohesh ? Si të marrësh pjesë ?

Ju falenderojmë përzemërsisht për interesin që keni ndaj projektit tonë të kërkimit, i cili përfaqëson për ne, një mbështetje shumë të vlefshme.

Për të marrë pjesë në këtë projekt ose për më shumë informacione, ju mund të na kontaktoni :

- **Me e-mail** : etude-parents@hesav.ch
- **Me telefon** : +41 21 556 65 07 (Znj. Aline Sadowski)
- **Nëpërmjet faqes web** : <https://hesav.ch/recherche/etude-parents>



Formulari i miratimit

| | |
|----------------------------------|---|
| Drejtuar | Pjesëmarrësve (-eve) në takime |
| Titulli i studimit | « Kushtet e punës dhe shëndetit të prindërve gjatë vitit të parë pas lindjes së fëmijës » |
| Institucionet përgjegjëse | Haute École de Santé – Vaud (HESAV, HES-SO) Unisanté – Departamenti i Shëndetit në punë dhe mjedisit |
| Përgjegjës i projektit | Isabelle Probst, psikologe PhD, profesore e asociuar në HESAV Haute École de santé - Vaud (HES-SO). Peggy Krief, mjeke pune MD, zv-mjeke dhe lektore për mësimdhënien dhe kërkimin klinik në Unisanté. |

Zonjë, zotëri,

Ju propozojmë të merrni pjesë në takim, në kuadër të një projekt kërkimi.

Lexoni me kujdes udhëzuesin e informacionit bashkangjitur dhe këtë formular. Mos hezitoni të bëni pyetje kur ju nuk kuptoni diçka ose kur dëshironi të keni saktësime.

Pjesëmarrës-e : Mbiemri dhe emri (me shkronja shtypi) :

- Duke nënshkruar këtë formular, unë pranoj të marrë pjesë në kërkimin « Kushtet e punës dhe shëndetit të prindërve gjatë vitit të parë pas lindjes së një fëmije ».
- Deklaroj se jam i/e informuar me gojë për objektivat dhe mënyrën e zhvillimit të kërkimit.
- Marr pjesë në këtë projekt kërkimi me vullnet të lirë dhe pranoj përmbajtjen e letrës informative që më është dhënë. Kam pasur kohë të mjaftueshme për të vendosur. Pjesëmarrja ime është plotësisht e lirë.
- Kam marrë përgjigje të kënaqshme në lidhje me pyetjet që kam bërë për pjesëmarrjen time në këtë kërkim.
- Në çdo moment, mund të kërkoj informacion shtesë dhe të anuloj miratimin tim për të marrë pjesë në këtë projekt kërkimi, pa pasur nevojë të justifikohem.
- E di që të dhënat e mia do të përdoren për qëllime kërkimi dhe mësimi vetëm nga anëtarët e ekipit të kërkimit. Të dhënat e mia do të jenë të koduara : emri im do të zëvendësohet me një kod, si edhe vendi i punës apo informacione të tjera që do mund të më identifikojnë. Personat e autorizuar që do konsultojnë të dhënat e mia angazhohen të trajtojnë informacionet që janë aty në mënyrë plotësisht të fshehtë. Institucionet përgjegjëse sigurojnë një mbrojtje të të dhënave sipas normave dhe kërkesave zvicerane, në bazë të Ligjit federal për mbrojtjen e të dhënave.

Vendi, data :

Nënshkrimi i
pjesëmarrësit/ses :

Kërkues/ese : Mbiemri dhe emri (me shkronja shtypi) :

Vërtetim i kërkuesit/es që siguron informacionin :

Me këtë vërtetim, vërtetoj se kam i shpjeguar pjesëmarrësit/es natyrën, rëndësinë dhe qëllimin e projektit. Deklaroj se do respektoj të gjithë detyrimet në lidhje me këtë projekt sipas ligjit në fuqi. Nëse mund të informohem, gjatë realizimit të këtij projekti, për informacione që mund të influencojnë në miratimin e pjesëmarrësit/es që të përfshihet në projekt, angazhohem se do informoj menjëherë.

Vendi, data :

Nënshkrimi i kërkuesit/es :